

Rekomandimet e OSBE/ODHIR: Zgjedhjet vendore 2023

Rekomandime prioritare

Nr.	Rekomandimi OSBE/ODIHR	Statusi implementimit	Komente dhe shënime të tjera
7	Autoritetet duhet të garantojnë zbatimin e duhur të Ligjit për të Drejtën e Informimit, të dekriminalizojnë shpifjen dhe të mbështesin gazetarinë e pavarur.	Progres i Pamjaftueshëm	Zbatimi i këtij rekomandimi kërkon angazhim për rregullime në legjislacion dhe për informimin, edukimin dhe ndërgjegjësim qytetar. Rregullimet dhe amendimet në legjislacion duhet të synojnë zvogëlimin e hapsirave për përdorimin e shpifjes në funksion të garës elektorale dhe për të mbështetur gazetarinë e pavarur. Është e nevojshme që Komisioneri për të Drejtën e Informimit, në bashkëpunim edhe me KQZ të angazhohet në mënyrë më efektive për të ndërtuar instrumenta dhe rrugë për rritjen e cilësisë në informimin e publikut. Angazhimit dhe kontributit të Shoqërisë civile duhet t`i kushtohet vëmëndje e veçantë.